



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1675/8 prot.

Datë 13.10.2021

V E N D I M

Nr. 755/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.10.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-00640-07-09-2021, me objekt: “*Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë e Shkodrës*”, me fond limit 102,951,379.98 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 12.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “Rej” SHPK.
Zogu i Zi, Qatar Center, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër
Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 - Shkodër

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020

“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.07.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-00640-07-09-2021, me objekt: “Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë e Shkodrës”, me fond limit 102,951,379.98 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 12.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 23.08.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

“Rej” SHPK	92.428.860 lekë, skualifikuar
“Malvin” SHPK	102.656.964 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “Rej” SHPK është njoftuar për arsyet e skualifikimit të tij si vijon:

- *Nuk plotesoni kriterin e kualifikimit sipas shtojces nr.9”Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit”, seksioni II, pasi nuk keni ne fushen e veprimtarise, pas verifikimit te QKB tuaj, seksioni 9, Objekti i aktivitetit”, objektin e prokurimit “shërbimin e gjelberimit”*
- *Nuk plotesoni piken 2.3.1 te kapacitetit teknik , për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 30,000,000 (Tridhjetë milion) leke, pasi ju keni paraqitur si shërbime te ngjashme kontratat si me poshte:
-“Sistemim i Odeonit ne qender te qytetit Pogradec”, ku referuar zerave te preventivit nuk ka asnje ze te ngjashem te realizuar me objektin e prokurimit.
-“Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave te qytetit Pogradec dhe NJ.A”, ku referuar zerave te preventivit vetem njeri prej tyre eshte pjeserisht i ngjashem me objektin e prokurimit, ” pastrim plazhi nga mbeturinat,+plugim dhe lesim+pastrimi i bregut te liqenit nga algat me mjet special te posacem i pajisur me traktor terheqes” ku kjo vlere shkon afersisht 6,625,920 leke
-Fatura tatimore shitje me Spitalin Amerikan ku vlere e shërbimit te ngjashem shkon 5000 euro*
- *Nuk plotesoni piken 2.3.3 dhe piken 2.3.4 te kapacitetit teknik, pasi certifikata ISO 9001:2015 “Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” dhe Certifikatë ISO 14001-2015 “Sistemet e Menaxhimit Mjedisor”” nuk kane te perfshire ne objektin e veprimtarise, objektin e prokurimit” shërbimin e gjelberimit”*
- *Nuk plotesoni piken 2.3.5 te kapacitetit teknik, pasi per drejtuesin teknik te shërbimit te gjelberimit ing.V. Terpollari ju nuk keni paraqitur CV.*
- *Nuk plotesoni piken 2.3.5 te kapacitetit teknik, pasi per drejtuesin teknik të shërbimit të gjelberimit ing.V. Terpollari, ju nuk keni paraqitur dokumentacion provues per te vertetuar se ka një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të gjelberimit.*
- *Nuk plotesoni piken 2.3.6 te kapacitetit teknik, pasi tek cv e paraqitur per inxhinierin e pyjeve nuk deklarohet se punon prane shoqerise REJ ShPK.*

II.3. Në datën 30.08.2021 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike nr.130, të Agjencisë së Prokurimit Publik.

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 08.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Rej” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të

procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr prot 1675/2 date 09.09.2021, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Rej” SHPK.

II.6. Me shkresën nr. 15161 prot, datë 10.09.2021, me objekt “Informacion”, protokolluar me tonën me nr. 1675/3 prot datë 15.09.2021, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik, për mosmarrjen në shqyrtim të ankesës, pasi është paraqitur jashtë afateve ligjore të ankimimit.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 1675/4 prot., datë 21.09.2021 me objekt: “*Kërkesë për paraqitje dokumentacioni lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Rej” SHPK*”, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të dërgojë pranë këtij Komisioni të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për trajtimin e ankesës.

II.8. Në datën 30.09.2021 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1675/5 prot., shkresa nr. 16245 prot., e autoritetit kontraktor me objekt: “Informacion”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi hartimin e dokumenteve të tenderit dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit.

II.9. Në datën 04.10.2021, me anë të shkresës nr. 1675/6 prot., Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga operatori ekonomik ankimues “Rej” SHPK, që të paraqesë pranë KPP-së, një “Printim ekrani” të mesazheve që i janë dërguar këtij të fundit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) nga autoriteti kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe çdo provë tjetër që vërteton marrjen dijeni nga ankimuesi mbi njoftimin e fituesit.

II.10. Në datën 11.10.2021, është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1675/7 prot., shkresa e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK me nr. 108 prot, datë 06.10.2021, në të cilën pasqyrohet “Printim ekrani” të rubrikës mesazhe në llogarinë e tij në SPE, me anë të së cilës vërteton se nuk është njoftuar nëpërmjet SPE lidhur me njoftimin e fituesit.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Përpara shqyrtimit në themel të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK, Komisioni vlerëson të ndalet dhe të shqyrtojë respektimin e kushteve formale të ankesës nga operatori ekonomik ankimues, ku një prej të cilave është respektimi i afateve të ankimit.

III.1.1. Në nenin 4, pika 41, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, përcaktohet se:

“Sistem i prokurimit elektronik” është një bazë të dhënash shtetërore, e krijuar sipas legjislacionit në fuqi e që përdoret për kryerjen e procedurave të prokurimit publik dhe administrohet nga Agjencia e Prokurimit Publik”

III.1.2. Në nenin 97, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, është parashikuar se:

“1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.

2. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në formë shkresore, autoriteti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike. Me publikimin e njoftimit të fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike, operatorëve ekonomikë iu lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.”

III.1.3. Në datën 04.10.2021, me anë të shkresës nr. 1675/6 prot., Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga operatori ekonomik ankimues “Rej” SHPK, që të paraqesë pranë KPP-së, një “Printim ekрани” të mesazheve që i janë dërguar këtij të fundit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) nga autoriteti kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, si dhe çdo provë tjetër që vërteton marrjen dijani nga ankimuesi mbi njoftimin e fituesit.

III.1.4. Në datën 11.10.2021, është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1675/7 prot., shkresa e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK me nr. 108 prot, datë 06.10.2021, në të cilën pasqyrohet “Printim ekрани” i rubrikës mesazhe, në llogarinë e tij në SPE, dhe vërteton se nuk është njoftuar nëpërmjet SPE, lidhur me njoftimin e fituesit.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje pikën 2 të nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*. Ndërsa në formularin e njoftimit të fituesit, të publikuar në buletin nr.130, datë 30.08.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, i cili është formular standard i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe është i përfshirë në dokumentet standarde të tenderit, përcaktohet: *“Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.*

III.1.6. Sa më sipër, bazuar në përcaktimet sipërcituara, si dhe bazuar në parashikimet ligjore në fuqi për prokurimin publik, Komisioni gjykon se në rastin konkret, përlllogaritja e afatit për të paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, nis nga dita e marrjes dijeni nga operatorët ekonomik mbi njoftimin e fituesit dhe përfundon ditën e dhjetë. Komisioni thekson se për sa kohë që, operatori ekonomik “Rej” SHPK, nuk ka marrë dijeni nëpërmjet SPE mbi njoftimin e fituesit, si dhe për sa kohë që në formularin standard të njoftimit të fituesit, të publikuar në buletin nr.130, datë 30.08.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është përcaktuar se me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, atëherë përlllogaritja e afateve për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, do të nisë nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit në buletin e njoftimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik. Në këto kushte, Komisioni gjykon se në rastin konkret, përlllogaritja e afatit për të paraqitur ankesë sipas nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nis që nga data 30.08.2021, dhe përfundon në ditën e dhjetë.

Sa më sipër, ankesa e operatorit ekonomik “Rej” SHPK është paraqitur brenda afateve të përcaktuara në bazën ligjore të sipërcituar, e për rrjedhojë Komisioni vendosi të shqyrtojë në themel këtë ankesë.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK se: *“Nuk plotesoni piken 2.3.1 te kapacitetit teknik, për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 30,000,000 (Tridhjetë milion) leke, pasi ju keni paraqitur si sherbime te ngjashme kontratat si me poshte:*

-*“Sistemim i Odeonit ne qender te qytetit Pogradec”, ku referuar zerave te preventivit nuk ka asnje ze te ngjashem te realizuar me objektin e prokurimit.*

-*“Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave te qytetit Pogradec dhe N.J.A”, ku referuar zerave te preventivit vetem njeri prej tyre eshte pjeserisht i ngjashem me objektin e prokurimit, “pastrim plazhi nga mbeturinat,+plugim dhe lesim +pastrimi i bregut te liqenit nga algat me mjet special te posacem i pajisur me traktor terheqes” ku kjo vlere shkon afersisht 6,625,920 leke*

-*Fatura tatimore shitje me Spitalin Amerikan ku vlera e sherbimit te ngjashem shkon 5000 euro”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, në shtojcën 8 *“Kriteret e veçanta për kualifikim”, “Kapaciteti teknik”,* pika 2.3.1, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kërkesën si vijon:

“2.3.1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 30,000,000 (Tridhjetë milion) Leke.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore*

të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

III.2.2. Në shtojcën 6 “Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit” të dokumenteve të tenderit, është kërkuar:

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë e Shkodrës**

Afatet e ekzekutimit: 36 muaj

Nr.	Analizë	Emërtimi i shërbimeve	Periudha 12 Mujore			
			Njësi	Sasi	Çmimi	Vlera
1	An. 1	Mirëmbajtja e Sipërfaqeve te gjelbra Tipi A	m ²	48,742.0		
2	An. 2	Mirëmbajtja e Sipërfaqeve te gjelbra Tipi B	m ²	39,051.0		
3	An. 3	Mirëmbajtja e Sipërfaqeve te gjelbra Tipi C	m ²	23,838.0		
4	An. 4	Mirëmbajtje Gjelbërimi Rrugor, Tipi 1 (lartësi deri në 5 m)	Copë	2,986.0		
5	An. 5	Mirëmbajtje Gjelbërimi Rrugor, Tipi 2 (lartësi 5 deri në 10 m)	Copë	1,824.0		
6	An. 6	Mirëmbajtje Gjelbërimi Rrugor, Tipi 3 (lartësi 10 deri në 15 m)	Copë	1,980.0		
7	An-7	Mirëmbajtje bimësie në vazo dekorative (xhabije kisha e zojes, pedonale)	Copë	250.0		
8	An-8	Mirëmbajtje stola dekorativ (rrugor)	Copë	464.0		
9	An-9	Mirëmbajtje shkurre dekorative (Rr. Mehmet Pashe Plaku)	Copë	800.0		
10	3-164	Mbjellje drurë dekorativ (në lulishte dhe gjelbërim rrugor)	Copë	200.0		
11	3-165	Mbjellje shkurre dekorative	Copë	120.0		
12	3-163	F.V Lule sezonale	m ²	1,070.0		
13	An-10	Mbjellje bordurë e gjelbër	ml	150.0		
14	3 -7	Shërbim I mirëmbajtjes së rrugës së Kalasë (shkulje rrenjeve bimeve te vogla)	m ²	9,440.0		
15	3 -2	Shërbim I mirëmbajtjes së rrugës së Shirokes dhe bregut të Liqenit, (prerje bimë te vogla)	m ²	68,600.0		
16	An-11	Pastrimi i bregut te liqenit(pjesa ujore) prej papastertive, alga, mbeturina druri, plastike etjer.	m ²	20,000.0		
17	An-12	Mirëmbajtje e sipërfaqeve ujore Qytet	m ²	650.0		
18	An-12/3	Mirëmbajtje sipërfaqe ujore Velipoje	m ²	491.0		

19		Zevendesim dhe shtim stolash dekorativ	Copë	70.0		
20		Zevendesim dhe shtim koshash	cope	70.0		
		Shuma vjetore pa TVSH	lekë			
		TVSH 20%	lekë			
		Shuma 12 mujore me TVSH	lekë			
		Shuma 36 mujore pa TVSH	lekë			
		TVSH 20%	lekë			
		Shuma 36 mujore me TVSH				

Grafik tipologjia A

Nr.	Proceset e Punës	Muaji											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Kositje tapet Bari (mbledhje + transport)				1	1	2	1	2	1	1	1	
2	Krasitja e drurëve dekorativë ne lulishte	1	1										1
3	Krasitje shkurre bordurë e gjelbër				1	2	2	1	1	1	1	1	
4	Krasitje shkurre gjetherënëse (të izoluar)		1		1	1		1		1			
5	Ujitja e luleve me tuba			2	2	2	4	6	8	6			
6	Ujitja e barit me tuba			5	5	10	20	22	22	16			
7	Mbjellja fidane të luleve			1	1		1			1			
8	Prashitja e fidanëve të luleve					1	1			1			
9	Punime me bel	1	1										
10	Nitrifikim sipërfaqe bari + lule					1			1				
11	Shpërndarje plehu organik	1	1										
12	Mirëmbajtje e veprave arkitekturore					1				1			
13	Luftim I sëmundjeve (spërkatje)			1		1							
14	Mirëmbajtje dhe fshirje rrugë e sheshe		1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1

	brenda në lulishte												
15	Pastrim I lulishtes	1	1	1	2	2	2	3	3	2	1	1	1
16	Heqja e barërave te këqija rrugore - sheshe (brenda lulishtes)			1		1		1	1	1			
17	Heqja e barnave tek lulet me cap (mihje)					1	1		1				

Grafik tipologjia B

Nr.	Proceset e Punës	Muaji											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Kositje tapet Bari (mbledhje + transport)			1	1	2	2	1	2	1	1	1	
2	Krasitja e drurëve dekorativë ne lulishte	1	1										1
3	Krasitje shkurre bordurë e gjelbër				1	2	2	1	1	1	1	1	
4	Krasitje shkurre gjetherënëese (të izoluara)		1		1		1	1		1			
5	Ujitja e luleve me tuba			2	2	2	4	6	8	6			
6	Ujitja e barit me tuba			5	5	10	20	22	22	16			
7	Mbjellja fidane të luleve			1	1		1			1			
8	Prashitja e fidanëve të luleve					1	1			1			
9	Punime me bel	1	1										
10	Nitrifikim sipërfaqe bari + lule				1	1			1				
11	Shpërndarje plehu organik	1	1										
12	Mirëmbajtje e veprave arkitekturore					1				1			
13	Luftim I sëmundjeve (spërkatje)	1	1				1						
14	Mirëmbajtje dhe fshirje rrugë e sheshe brenda në lulishte			1	1	1	1	1	1	1	1		
15	Pastrim I lulishtes	1	1	1	2	2	2	3	3	2	1	1	1
16	Heqja e barërave te kqija rrugore - sheshe (brenda lulishtes)				1	1		1	1	1			
17	Heqja e barnave tek lulet me cap (mihje)						1	1	1				

Grafik Tipologjia C

Nr.	Proceset e Punës	Muaji											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Kositje tapet Bari (mbledhje + transport)			1	1	2	2	2	1	1	1	1	
2	Krasitja e drurëve dekorativë në lulishte	1	1										1
3	Krasitje shkurre bordurë e gjelbër			1	1	2	1	1	1	1	1	1	
4	Krasitje shkurre gjetherënëse (të izoluar)		1		1		1	1			1		
5	Ujitja e luleve me tuba			2	2	2	4	6	8	6			
6	Ujitja e barit me tuba			5	5	10	20	22	22	16			
7	Punime me bel	1	1						1				
8	Nitrifikim sipërfaqe bari + lule				1	1			1				
9	Shpërndarje plehu organik	1	1										
10	Mirëmbajtje e veprave arkitekturore					1				1			
11	Luftim I sëmundjeve (spërkatje)		1		1		1						
12	Mirëmbajtje dhe fshirje rrugë e sheshe brenda në lulishte		1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	
13	Pastrim I lulishtes	1	1	1	2	2	2	3	3	2	1	1	1
14	Heqja e barërave të këqija rrugore - sheshe (brenda lulishtes)				1				1	1			

Grafik Punimesh Tipi 1 i Pemëve

Nr.	Proceset e Punës	Muaji											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Prashitje, hedhje plehu tek druret dhe mirëmbajtja	1	1	1					1				
2	Krasitja e drurëve dekorativë	1	1										1
3	Vaditja e drurëve						1	2	2				
4	Grumbullimi mbeturina (nga krastijet)	1	1										1
5	Transport Mbeturina (deri 5 km)	1	1	1					1				1

Grafik Punimesh Tipi 2 i Pemëve

Nr.	Proçeset e Punës	Muaji											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Prashitj, hedhje plehu tek druret dhe mirëmbajtja	1	1	1					1				
2	Krasitja e drurëve dekorativë	1	1										1
3	Vaditja e drurëve						1	2	1				
4	Grumbullimi mbeturina (nga krasitjet)	1	1										1
5	Transport Mbeturina (deri 5 km)	1	1	1					1				1

Grafik Punimesh Tipi 3 i Pemëve

Nr.	Proceset e Punës	Muaji											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Prashitj, hedhje plehu tek druret dhe mirëmbajtja	1	1	1					1				
2	Krasitja e drurëve dekorativë	1	1										1
3	Vaditja e drurëve						1	1	1				
4	Grumbullimi mbeturina (nga krasitjet)	1	1										1
5	Transport Mbeturina (deri 5 km)	1	1	1					1				1

Grafik Punimesh Mirëmbajtje Bimësie në Vazo Dekorative (xhabije kisha e zojës, pedonale)

Nr.	Proceset e Punës	Muaji											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Prashitje e hedhje plehu në shkurre dekorative (5 herë)	1						1		1			
2	Kraistje e shkurreve me forma (2 herë)					1				1			
3	Grumbullim dhe heqje mbeturinash pas krasitjes (2 herë)					1				1			
4	Ujitje shkurre dekorative (5 herë)						1	2	2				

Grafik Punimesh Mirëmbajtje Stola Dekorativë

Nr.	Proceset e Punës	Muaji											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Mirëmbajtje elemente betoni dhe hekuri (4% ne vit)	Sipas Nevojës											
2	Mirëmbajtje e elementeve druri dhe lyere me bojë vaji (1 herë)												
3	Betonime stola nga demtime												

Grafik Punimesh Mirëmbajtje Shkurre Dekorative (Rruga Mehmet Pashë Plaku)

Nr.	Proceset e Punës	Muaji											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Prashitje, hedhje plehu në shkurre dekorative (2 here)	1		1			1		1				
2	Krasitje e shkurreve me forma dekorative (5 herë)					1			1				
3	Grumbullim e heqje mbeturinash pas krasitjes					1			1				
4	Ujitje shkurre dekorative (5 herë)						1	2	1	1			

Grafik Punimesh Mbjellje Drurë Dekorativ (në lulishte dhe gjelbërim rrugor)

Nr.	Proceset e Punës	Muaji											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Hapje grope 100x100x100 cm												
2	Transport dheu vegjetal + mbushje grope												
3	Pleh organik												
4	FV drurë dekorativ												
5	Vendosje mbajtëse druri												
6	Vendosje Kosh metalik mbrojtës												

Grafik Punimesh Mbjellje Shkurre Dekorative (Oleandër)

Nr.	Proceset e Punës	Muaji											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Hapje e gropave 50x50 cm												
2	Transport dheu vegjetal + mbushje grope												
3	Pleh organik												
4	FV Shkurre dekorative												

Grafik Punimesh Mbjellje Bordura te Gjelbra

Nr.	Proceset e Punës	Muaji											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Hapje kanali 40x40 cm												
2	Transport dheu vegjetal dhe mbushje kanali												
3	Pleh organik												
4	FV Gardhe te gjelbra												

Grafik Punimesh Mirëmbajtje e sipërfaqeve ujore

Nr.	Proceset e Punës	Muaji											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Fshirja e sipërfaqes së shatërvanit (12 herë)	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
2	Larje me tub gome e sipërfaqes së shatërvanit (12 herë)	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
3	Nxjerrja e mbeturinave me krah nga baseni dhe transporti I tyre	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
4	Vënie në punë e shatërvanit (çdo ditë)												

III.2.3.Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik “Rej” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë sipërmarrje me objekt: “Sistemim i Odeonit ne qender te qytetit Pogradec”, e lidhur në datën 01.12.2020 midis subjektit “Rej” SHPK dhe Bashkisë Pogradec, me

vlerë 37.8994.454,4 lekë me TVSH, shoqëruar me procesverbal kolaudimi dhe situacion pjesor nr.1.

2. Faturë tatimore shitje nr. 33, datë 30.04.2021 me Spitalin Amerikan, me përshkrimin: *“Shërbim pastrimi dhe mirëmbajtje muaji Prill 2021”* dhe vlerë 20.000 Euro.
3. Faturë tatimore shitje nr. 37, datë 31.05.2021 me Spitalin Amerikan, me përshkrimin: *“Shërbim pastrimi dhe mirëmbajtje muaji Maj 2021”* dhe vlerë 20.000 Euro.
4. Faturë tatimore shitje nr. 39, datë 30.06.2021 me Spitalin Amerikan, me përshkrimin: *“Shërbim pastrimi dhe mirëmbajtje muaji Qershor 2021”* dhe vlerë 20.000 Euro.
5. Kontratë shërbimi me objekt: *“Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave te qytetit Pogradec dhe N.J.A”*, e lidhur me datë 30.07.2020 me Bashkinë Pogradec, bashkëngjitur saj shkresa nr.36/1 prot., datë 07.01.2021 me objekt: *“Konfirmim realizimi me sukses të shërbimit dhe vërtetim për depozitim të mbetjes”*, lëshuar nga Bashkia Pogradec, sipas të cilës për periudhën 1 gusht 2020 - 31 dhjetor 2020 kontrata është realizuar me sukses. Kjo kontratë është shoqëruar me fatura tatimore shitje dhe situacione për periudhën gusht - dhjetor 2020 dhe fatura, situacione e procesverbale për periudhën janar - qershor 2021
6. Kontratë shërbimi me objekt: *“Vazhdim i shërbimit të pastrimit, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave te qytetit Pogradec dhe N.J.A për nevojat e fillimit të vitit për shkaqe të paparashikuara”*, e lidhur me datë 25.02.2020 me Bashkinë Pogradec, me vlerë 53.068.996 lekë pa TVSH, bashkëngjitur saj shkresa nr.3705/1 prot., datë 06.08.2020 me objekt: *“Konfirmim realizimi me sukses të shërbimit”*, lëshuar nga Bashkia Pogradec, sipas të cilës për periudhën 25 shkurt 2020 - 31 korrik 2020 kontrata është realizuar me cilësi dhe sukses nga shoqëria “Rej” SHPK. Kjo kontratë është shoqëruar me fatura tatimore shitje dhe situacione për periudhën shkurt - korrik 2020

III.2.4. Lidhur me këtë arsye skualifikimi, operatori ekonomik ankimues pretendon se:

“Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor nuk rezulton të jetë kërkuar që puna e ngjashme të jetë e njëjtë me atë të prokurimit, por e ngjashme, ndaj arsyeja e skualifikimit të dhënë nga ana e AK-së nuk qëndron. Autoriteti kontraktor duhet të bëjë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke përjashtuar këtu vlerësimin mbi dokumente shtesë të pakërkuara nga autoriteti kontraktor, të cilat për më tepër janë paraqitur nga OE ankimues. Për pasojë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit e, rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me këto kërkesa. Gjithashtu nga ana tjetër, OE ankimues ka nënshkruar deklaratën e përmbushjes së specifikimeve teknike, ku deklaroi plotësimin e të gjitha specifikimeve teknike, duke marrë përsipër, nën përgjegjësinë e tij, përmbushjen e këtyre të fundit, ka nënshkruar një sërë deklaratash, ku deklaroi se përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga AK. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga OE Rej SHPK, gjykojmë se punët e ngjashme të paraqitura për plotësimin e kriterit për punë të ngjashme ka për objekt të saj shërbim të ngjashëm me ato të kërkuar, siç dhe vetë autoriteti kontraktor citon, dokumente të cilat dëshmojnë se OE ka realizuar veprimtari të ngjashme. Me dokumentacioni e paraqitur OE Rej SHPK rezulton të provojë se ka

eksperiencën e kërkuar. Në rastin konkret gjykojmë se eksperiencia e paraqitur nga OE Rej SHPK dëshmon se ky i fundit ka realizuar shërbime të ngjashme me natyrën e objektit të prokurimit dhe me zerat konkretë të shërbimit, duke krijuar kështu bindjen për realizimin me sukses të kësaj kontrate. Për rrjedhojë arsyeja e skualifikimit për sa më sipër nuk qëndron.”

III.2.5. Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.2.6. Në nenin Neni 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.7. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit sa më sipër, të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Rej” SHPK, rezulton se është paraqitur një kontratë me objekt: *“Sistemim i Odeonit ne qender te qytetit Pogradec”*, e lidhur në datën 01.12.2020 midis subjektit “Rej” SHPK dhe Bashkisë Pogradec, shoqëruar me procesverbal kolaudimi dhe situacion pjesor nr.1. Kjo kontratë rezulton e pa shoqëruar me vërtetim realizimi, në kundërshtim me kërkesën e autoritetit, parashikuar në dokumentet e tenderit. Gjithashtu rezulton se situacioni pjesor, bashkëngjitur kësaj kontrate, përmban zërat FV *“Fidane lule dekorative”* dhe *“FV Fidane peme dekorative”* në sasinë 0. Zërat e tjerë të kontratës nuk janë të ngjashëm me objektin e prokurimit. Sipas të dhënave të kësaj kontrate dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj, nuk rezulton që kjo përvojë të jetë e ngjashme me objektin e prokurimit.

Gjithashtu rezulton se operatori ekonomik ankimes ka paraqitur tre fatura tatimore shitje për shërbimin e pastrimit dhe mirëmbajtjes së ambienteve të Spitalit Amerikan, nga shqyrtimi i të cilave konstatohet se shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit kapin vlerën 5000 Euro, vetëm për zërin *“Mirëmbajtja e sipërfaqeve të jashtme dhe sipërfaqeve të gjelbërta”*.

Së fundi rezulton se është paraqitur kontratë shërbimi me objekt: *“Vazhdim i shërbimit të pastrimit, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave te qytetit Pogradec dhe NJA për nevojat e fillimit të vitit për shkaqe të paparashikuara”*, e lidhur me datë 25.02.2020 me Bashkinë Pogradec, bashkëngjitur saj shkresa nr.3705/1 prot., datë 06.08.2020 me objekt: *“Konfirmim*

realizimi me sukses të shërbimit”; fatura tatimore shitje dhe situacione për periudhën shkurt - korrik 2020 si dhe është paraqitur kontratë shërbimi me objekt: “*Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe NJA*”, e lidhur me datë 30.07.2020 me Bashkinë Pogradec, bashkëngjitur “*Konfirmim realizimi me sukses të shërbimit dhe vërtetim për depozitim mbetjes*”, për periudhën 1 gusht 2020 - 31 dhjetor 2020; fatura tatimore shitje dhe situacione për periudhën gusht - dhjetor 2020; fatura, situacione e procesverbale për periudhën janar - qershor 2021. Nga krahasimi i situacioneve të paraqitura në zbatim të dy kontratave të sipërcituara, të realizuara nga operatori ekonomik “Rej” SHPK, me preventivin dhe specifikimet teknike të objektit të prokurimit, Komisioni konstaton se ky i fundit, dëshmon se ka kryer shërbime të ngjashme vetëm për një pjesë të shërbimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi dëshmitë e paraqitura nga operatori ekonomik “Rej” SHPK lidhen vetëm me shërbime pastrimi, grumbullimi dhe largimi të mbeturina si dhe pastrim i bregut të liqenit (pjesa ujore), mirëmbajtja e sipërfaqeve ujore por nuk dëshmon përvojën e nevojshme për ofrimin e shërbimit të gjelbërimit, të cilat, referuar volumeve sasiore të parashikuara në preventiv, si edhe vlerës së ofruar për këto zëra, në preventivin e paraqitur nga vetë operatori ekonomik “Rej” SHPK, zënë mbi 70 % të volumit të kontratës që prokurohet. Komisioni vlerëson se ofrimi i shërbimit të gjelbërimit kërkon ekspertizë dhe eksperiencë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga ankimesi me anë të kontratave të sipërcituara.

Komisioni gjykon se krahasueshmëria e eksperiencave të mëparshme të ofruara nëse janë të ngjashme me objektin e prokurimit, nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës nëse ajo është një kontratë mirëmbajtje, por duhet parë në lidhje me të gjithë zërat konkretë të shërbimeve të kryera.

Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK për të provuar kapacitetin e tij teknik për përvojën e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, nuk përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor që *operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30,000,000 lekë*. KPP gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me shërbimet objekt-prokurimi, por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Në këto kushte, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Rej” SHPK nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me përvojën e mëparshme.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimesi nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimesi “Rej” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë, pasi operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-00640-07-09-2021, me objekt: “Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë e Shkodrës”, me fond limit 102,951,379.98 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 12.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri